



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës  
Press Council of Kosovo  
Savet Štampe Kosova

**25 shtator 2017, Prishtinë,  
Ref:20.07.2017\567-2017**

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj  
ankesës së Shaban Ramës kundër portalit Botapress**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 19 shtator 2017, shqyrtoi ankesën e Shaban Ramajt kundër portalit Botapress lidhur me artikullin "Skandaloze: Veterani i UÇK-së Shaban Ramaj-Shabi, kërcënon dhe ofendon Hysen Fejzën, babain e dëshmorit Shkodran Fejza", botuar më 7 korrik 2017, dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa miratohet

## A R S Y E T I M I

Në ankesën e Shaban Ramajt thuhet se ish ushtari i UÇK-së, Shkodran Fejza ka vdekur në një aksident, disa vite pas përfundimit të luftës, për çka ankuesi i paraqiti dëshmi KMSHk-së.

Gjithashtu në ankesë thuhet se nuk është e vërtetë se ai e ka kërcënuar me armë Hysni Fejzën, babain e dëshmorit Shkodran Fejza, pasi për këtë nuk ekziston asnjë dëshmi e organeve përgjegjëse.

Sikundër nuk ka asnjë vendim gjyqësor i cili mbështetë të kaluarën kriminale të ankuesit, thuhet në ankesë.

Në ankesë thuhet se para se të publikohet ky artikull është dashur të kërkohet edhe prononcimi i ankuesit, Shaban Ramajt.

KMSHk, pasi shqyrtoi artikullin, ankesën dhe dokumentet, siç është ai i shoqatës së familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, ku shihet se emri i Shkodran Fejzës nuk figuron si dëshmor i kombit, me çka BotaPress ka shkelur Kreu II (Raportimi i së vërtetës) të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Gjithashtu KMSHk-së konstatoi se sikur redaksia e Bota Press të kishte kërkuar prononcimin e Shaban Ramajt para publikimit të artikullit, shumë çështje do të sqaroheshin dhe nuk do të krijoheshin këso probleme edhe të natyrës emocionale.

Vendimi u mor me shumicën e votave të të gjithë të pranishmëve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMSHk vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**